



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 192, Datë 21.07.2022

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “TREN SUN SYSTEM” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “a”, dhe nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a”, nenit 10, pikat 4-6, dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.07.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1144/2 prot., datë 19.07.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “TREN SUN SYSTEM” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 85, datë 20.04.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “TREN SUN SYSTEM” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike Centrali Fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2000 kW në zonën Bitinckë, Bilisht, Qarku Korçë, për një afat 25 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 70/12 prot., datë 22.04.2022, bëri njoftimin në media për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve dhe objeksioneve (datë 05.05.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 449/1 prot., datë 27.04.2022, njoftoi shoqërinë për vendimin e bordit nr. 85/2022, duke i evidentuar dhe dokumentacionin e munguar apo të plotësuar pjesërisht nga ky aplikim.

- Duke qenë se nuk u depozitua dokumentacion nga shoqëria, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 141, datë 06.06.2022, vendosi të refuzojë licencimin e shoqërisë “TREN SUN SYSTEM” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW.
- Në të njëjtën datë, pas mbledhjes së bordit, shoqëria ka depozituar dokumentacion me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 449/2 prot., datë 06.06.2022. Në vijim me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 449/3 prot., datë 07.06.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues.
- Referuar përcaktimeve të nenit 10, pikave 5, 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, pavarësisht se parashikohet e drejta e aplikuesit për paraqitjen e një aplikimi të ri brenda 30 ditëve nga vendimi për mosfillimin e procedurës, dhe bazohet te neni 6, i cili nga ana e tij ka të bëjë me refuzimin e kërkesës për licencim, është e qartë se në këto rrethana kjo e drejtë i njihet aplikuesit dhe në rastet kur është marrë vendimi për refuzimin e kërkesës, pasi kushti thelbësor nuk është procedura në këtë rast, por afati, pra ka të bëjë me gatishmërinë e aplikuesit për t’iu përgjigjur udhëzimeve të dhëna nga ERE brenda 30 ditëve. Shoqëria e ka paraqitur dokumentacionin brenda këtij afati, çka evidenton vullnetin dhe gatishmërinë e saj për të plotësuar sa kërkuar nga ERE.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike; si dhe lejet nga institucionet respektive. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:
 - Formatin dhe dokumentacionin për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
 - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”.
 - Dokumentacionin financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.
 - Dokumentacionin teknik për centralin fotovoltaik - neni 9, pika 4.4.1, pika 4.4.2, pika 4.4.3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d” dhe pika 4.4.4, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Leje nga institucione të tjera - neni 9, pika 4.4.5, gërmat “a” dhe “b”.
- Në lidhje me kërkesën e nenit 9, pika 2, gërma “g”, vlerësohet t’i lihet kusht shoqërisë në vendim, që të përcjellë në ERE jo më vonë se data 11.09.2038, kontratat e qirasë të rinovuara ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë.
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe neni 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga Studimi i Fizibilitetit të centralit fotovoltaik 2 MW rezulton se jetëgjatësia e një paneli shkon 25 – vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “TREN SUN SYSTEM” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, Qarku Korçë, me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25-vjeçar.
2. Shoqëria “TREN SUN SYSTEM” sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE jo më vonë se data 11.09.2038, kontratat e qirasë për zonën ku do të shtrihet projekti të rinovuara, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI